



Prishtinë, 28 janar 2016
Kodi i ZRRE-së: V_777_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 12.1.20 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 7 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 30.10.2015 dhe 02.12.2015 për shqyrtim dhe aprovimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2016 – 2025”

në seancën e mbajtur me datë 28.01.2016, nxori këtë:

V E N D I M

I Aprovohet “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2016 – 2025” i KOSTT-it

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 30 tetor 2015 ka pranuar kërkesën për komentim dhe aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2016 – 2025” të KOSTT SH.A. Në ndërkohë dokumenti ka qenë i publikuar në ueb faqen e KOSTT-it për diskutim publik. ZRRE ka dhënë komentet e veta të cilat janë përfshirë në dokument, janë sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura.

Po ashtu janë mbajtur dy takime me përfaqësues të KOSTT për të diskutuar rreth disa projekteve, si dhe përputhshmërisë me projektet e parapara me planin investiv të KOSTT.

Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së dhe MZHE-së, KOSTT me datë 02 dhjetor 2015 ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE.



ZRRE ka analizuar dokumentin dhe vlerëson se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurtë të sistemit të transmisionit dhe operimin e tregut. Për disa projekte të cilat parashihen për periudhën e fundit të përfshirë në Planin zhvillimor, mbetet të vazhdohet të monitorohet fizibiliteti i investimit të tyre në të ardhshmen, sidomos duke pasur parasysh periudhën kohore të ndërtimit, dhe këto projekte janë përmendur në komentet e ZRRE dërguar në KOSTT. Pavarësisht kësaj konsiderojmë se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara, kështu që **aprovon “Planin Zhvillimor të Transmisionit 2016 – 2025”**.


- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfi, anëtar